



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Br 141/15

Nr. i fq. / Br. st - 7 -

Data / Datum 25.06.2015

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTZAKONSHME (E VI-të ME RADHË) E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 04 QERSHOR 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 16:07.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatime Haziri, Habibe Gërxhaliu, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani.

Munguan: Qerim Selimi dhe Zoran Rakiç anëtar të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi me vota unanime aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për marrjen e pëlqimit elektroenergjetik për fabrikën e ujit në fshatin Balincë.
2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit lidhur me rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015.
3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për pagesën e transportit të nxënësve në Komunën e Vushtrrisë.
4. Shqyrtim i Propozim-Vendimit për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit.

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për marrjen e pëlqimit elektroenergjetik për fabrikën e ujit në fshatin Balincë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se duke parë nevojën e madhe të qytetarëve për ujë të pijshëm mund të thuhet se është shumë imediate lëshimi në funksion i fabrikës së ujit, sidomos tani kur po i ofrohem periudhës së nxehtë kur dihet fakti se uji është një element jetësor për njeriun. Tutja ai duke u lëshuar në përmbajtjen e propozim-vendimit në fjalë ceku se në arsyetimin e këtij propozimi thuhet se lejimi i kyçjes së këtij impianti në rrjetin elektrik na është kushtëzuar me pagesën paraprake për pëlqim elektroenergjetik. Andaj në këtë kontekst ai pyeti drejtoritë komunale se a kemi vepruar kështu edhe kur ka qenë në pyetje interesi jonë, dhe shtoi se ai ka një informatë nga Drejtoria e Urbanizmit se KEDS-it më herët nga komuna jonë i është dhënë një pëlqim parimor për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me kërkesën e tyre për fillimin e vendosjes së orëmatësve në komunën tonë për marrjen e lejes nga organi kompetent. Pastaj ai vlerësoi se të gjithë ne jemi dëshmitar se në këtë formë nuk ka vepruar KEDS-i, por nuk kanë vepruar as institucionet tona sikurse është Drejtoria e Urbanizmit, Inspeksioni dhe akterët tjerë kompetent që të veprojnë së bashku dhe të kushtëzojnë që jo ta ndalojnë por ta obligojnë që KEDS-i t'i përmbush obligimet ndaj komunës çfarë janë ato. Andaj në krejt këtë relacion ne si komunë nuk mund të jemi “kaq dorëlibër” kur ne duhet të paguajmë, kurse kur dikush kërkon nga komuna jonë të merr atë pa ndonjë obligim paraprak. Në fund ai tha se edhe KEDS-i në këtë çështje duhet të kushtëzohet sikurse ne jemi kushtëzuar prej tij, që ne jemi të gatshëm të paguajmë këtë shumë, por edhe ata të obligohen që në afatin sa më të shpejt të bëjnë zhvendosjen e orëmatësve nga shtyllat elektrike, të cilat janë vendosur pa kurrfarë kriteri.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për marrjen e pëlqimit elektroenergjetik për fabrikën e ujit në fshatin Balincë, neve na intereson ta dimë sesi është e mundur që të planifikohet një projekt kaq i madh në vlerë mbi 8 milionë euro dhe aty të mos parashihen mjete financiare për marrjen e këtij pëlqimi elektroenergjetik, duke e ditur që ju keni fituar dy mandate të qeverisjes në komunë, pikërisht me premtimin se do të kemi ujë të pijshëm 24 orë në ditë, ndërkohë që akoma qytetarët e Vushtrrisë vazhdojnë të ballafaqohen me mungesë të ujit të pijshëm. Pyetja që e parashtrijmë ne është: a do të zgjidhet përfundimisht problemi i mungesës së ujit të pijshëm me ndarjen e këtyre mjeteve financiare dhe marrjen e pëlqimit elektroenergjetik. Nëse po, na tregoni se kur do të funksionalizohet kjo fabrikë apo prapë do të ketë zvarritje dhe do të kërkojnë mjete financiare shtesë për të njëjtin problem në të ardhmen.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se beson se ai dhe shumica e anëtarëve të kuvendit janë pro zgjidhjes së shpejtë të problemit me ujë të pijshëm sepse edhe ashtu është vonuar shumë ky projekt, mirëpo përkundër vullnetit tonë propozim-vendimi që sot e kemi në rend dite ceku se ka dyshime se nuk është në harmoni me ligjin, për faktin se asetet për të cilat pretendohet të bëhet pagesa nuk i posedon komuna, dhe se për këtë çështje ne nuk kemi të planifikuara mjete financiare për këtë projekt. Tutje shtoi se vet fakti që asetet nuk janë pronë e komunës rezulton që komuna po bënë pagesa ndaj palëve të treta dhe se kjo e vështirëson së tepërmi përkrahjen e këtij propozim-vendimi, mirëpo sidoqoftë ne si anëtarë të kuvendit është dashur që të na jepet një sqarim shtesë nga Zyra ligjore mbi bazën ligjore të këtij propozim-vendimi. Gjithashtu edhe Drejtoria e Financave është dashur të na jep përgjigje se nga cili fond parasheh të bëjë pagesën e këtyre mjeteve dhe se si dhe ku do ta raportojë këtë pagesë pasi që nuk është aset i komunës qysh do të arsyetohet kjo pagesë në cilin kod ekonomik pasi kjo pagesë është për palë të treta.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për kyçjen e ujës-jellësit në rrjetin elektrik dihet se 10 KW është aset i “Ibër Lepencit” dhe në këtë rast KEDS-i nuk ka kurrfarë harxhimesh andaj një pagesë e tillë nuk dinë se për çfarë po bëhet.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se grupi kuvendar i LDK-së nuk ka asgjë kundër ndarjes së këtyre mjeteve edhe pse ky projekt është vonuar tepër dhe janë bërë vite të tëra pa u përfunduar ky projekt. Tutje pyeti se pas ndarjes së këtyre mjeteve kur Vushtrria do të ketë ujë, d.m.th a kemi ne një afat një datë se kur do të nisë së funksionari kjo fabrikë.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit – lidhur me këtë propozim-vendim parashtrroi një pyetje lidhur me emërtimin e kategorisë ekomomike dhe drejtorisë nga e cila lejohen mjetet për këtë pagesë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – tha se pajtohem me konstatimin e përgjithshëm se është bërë gjatë që kjo fabrikë nuk është lëshuar në funksion dhe është bërë gjatë që qytetarët ende janë pa ujë të bollshëm. Tutje shtoi se nuk ka qenë dëshira e tij që kjo çështje të zvarritet dhe ceku se ky projekt nuk ka qenë i komunës por i ministrisë, dhe ka bërë përpjekje që të bëhet alokimi i mjeteve dhe të bëhet shpejt zgjidhja e këtij problemi. Pastaj ai sqaroi se ky projekt ka pasur një dinamikë prej 3 viteve, por me kërkesën e kontraktuesit për mbi 200 ditë pune dhe se sipas informatave verbale që i ka dhënë kompania, impianti për trajtimin e ujit të pijshëm është i gatshëm që të lëshohet por me kusht që të bëhet pranimi teknik dhe për një pranim të tillë është i nevojshëm që të bëhet testimi i makinave, të cilat e bëjnë pastrimin e ujit. Mandej njoftoi se për t’u bërë testimi i këtyre makinave kjo nuk ka mundësi që të bëhet me gjenerator, por duhet që fabrika të kyçet në rrjetin energjetik. Këtë problem e ka shtruar kompania dhe ka dëshmuar se kjo çështje nuk ka qenë e paraparë në projekt edhe pse shumë më herët ka bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për zgjidhjen e këtij problemi që të hedhen mjete shtesë për përfundimin e këtyre punëve, por ata nuk kanë vepruar në këtë drejtim. Tutja njoftoi se në konsultim edhe me nivelin qendror ka biseduar lidhur me çështjen e përcaktimit të pronësisë së kësaj fabrike, dhe për këtë është formuar një komision duke përfshirë përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Ministrisë së Financave, pastaj përfaqësuesit e Rregullatorit të Ujërave, përfaqësuesit nga Kompania Mitrovica dhe përfaqësuesit e Komunës së Vushtrrisë, dhe ky komision do të merret me çështjen e definimit të pronësisë së kësaj fabrike. Mandej njoftoi se operatori kontraktues i ndërtimit të fabrikës ka për obligim që tre muaj të mbajë në testim fabrikën dha pas kësaj periudhe nëse bëhet pranimi teknik fabrika lëshohet në prodhim. Gjithashtu ai tha se për shkak të kësaj gjendjeje rreth këtij pëlqimi ne si komunë nuk kemi gjetur mbështetje për faktin se ndërmarrja “Mitrovica” ka njoftuar se nuk ka mjete për financimin e këtij projekti, dhe në këtë kontekst tha se ka menduar që nuk është e drejtë që për një shumë të tillë të mjeteve të mbetet pa u lëshuar kjo fabrikë. Tutje tha se raportet mes komunës dhe KEDS-it nuk janë duke shkuar si duhet përkundër faktit se me ambasadorin e Turqisë ka biseduar lidhur me këtë çështje, si dhe me menaxhmentin e KEDS-it lidhur me problemet që kanë qytetarët me këtë kompani, kurse lidhur me pëlqimin energjetik citojmë se ka biseduar me përfaqësuesit e KEDS-it dhe ka marrë premtimin se çështja e pëlqimit do të përfundohet shumë shpejt. Pastaj ai njoftoi se një pëlqim të tillë KEDS-i njëherë e ka aprovuar por të njëjtin e ka anuluar me obligimin që për këtë çështje të bëhet pagesa e pëlqimit energjetik, në të kundërtën ky pëlqim nuk do të jetë i plotfuqishëm. Ndërkaq lidhur me çështjen që rrjeti i 10 KW është pronë e “Ibër Lepencit”, njoftoi se ka marrë pëlqim edhe nga ana e tyre që ky impiant të kyçet në rrjet. Në fund tha se kur bëhet fjalë për ligjshmërinë e vijës buxhetore njoftoi se ka biseduar me zyrtarët e Drejtorisë së Financave dhe është siguruar se nuk do të ketë problem të kësaj natyre.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota “për”, tjerat “abstenim”, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim lejohet pagesa e mjeteve në shumën prej 20,156.39€, për pagesën e Pëlqimit elektroenergjetik për impiantin e ujit në fshatin Balincë, nga kategoria "Shërbime Komunale" e DSHP-së.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

2. Shqyrtim i Propozim-Vendimit lidhur me rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2015.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se tek tabela 4.1 e propozimit për rishikimin e buxhetit ku shkruan plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2015, kishte me qenë mirë të ishte plani i ndarjeve sipas ridestinitimit të mjeteve. Pastaj ceku se në tabelat 1, 2 dhe 3 kemi shpërputhje tek mjetet e ndara për paga në shumën prej 8.150€, prej mallrave dhe shërbimeve janë marrë 1.675€ ndërsa totali është 7.955€, dhe të gjitha këto kur mbledhen nuk kemi përputhje për shumën prej 179 €, për faktin se këto mjete nuk dihen se nga kanë ardhur. Tutje tek tabela 4.2 janë 10.000€ të caktohet destinimi i këtyre mjeteve të tepruara nga projekti serrat, por nuk është e kuptueshme se nga cili pozicion vijnë dhe thuhet se janë dedikuar për renovimin e shkollave dhe për këtë kërkoi sqarim. Pastaj ceku se kur jemi tek materialet e kuvendit që ngërthejnë në vet shifra, mirë kishte me qenë që këto materiale të fotokopjohen vetëm nga njëra anë, me qëllim që të lexohen më lehtë. Në fund ajo tha se nuk është mirë që rishikimi i buxhetit të vonohet në këtë formë për faktin në Drejtorinë e Buxhetit janë tre punëtorë që merren me këtë çështje dhe kjo tregon për papërgjegjësinë e këtyre zyrtarëve.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – kërkoi që të bëhet definimi i projekteve sidomos ato që kanë të bëjnë me renovimin e shkollave. Tutje ai propozoi që në kuadër të rishikimit të buxhetit të futet një rrugë në fshatin Pasomë e cila ka mbetur në gjysmë, ku për të njëjtën rrugë janë shpenzuar 34.000€, kurse vitin e kaluar janë alokuar 40.000€ dhe kanë tepruar 6.000€ € nga i njëjti projekt. Tutje ceku se një pjesë e kësaj rruge është rregulluar, kurse një pjesë e madhe e saj ka mbetur e parregulluar, andaj kërkoi nga kuvendi që ky projekt të përfundohet.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke parashtruar të dhëna për pozicionet ekonomike në të cilat bëhet rishikimi i mjeteve financiare nga rishikimi i buxhetit komunal për vitin 2015.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës – njoftoi kuvendin se në fshatin Stanoc i Epërm është menduar të bëhet një muri mbrojtës dhe të bëhet rregullimi i disa urave për faktin se këta janë shkaktarët për bllokimin e kanaleve dhe vërshimet që po ndodhin në këtë lokalitet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015, në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2015 të MEF-it, dhe kërkesave të programeve buxhetore të komunës.
2. Mjetet e rishikuara barten sipas tabelës standarde, 4.1 dhe 4.2 që janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për pagesën e transportit të nxënësve në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim bëhet pagesa e transportit të nxënësve nga të hyrat vetanake, (fondi 22) nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve prej këtyre programeve buxhetore:

1.1 Zyra e Kryetarit, kodi i programit, nënprogramit 16024, shuma e mjeteve 4,736.62€

1.2 Drejtoria e Administratës, kodi i programit, nënprogramit 16324, shuma e mjeteve 1,713.23€

1.3 Drejtoria e Prokurimit, kodi i programit, nënprogramit 16820, shuma 2,012.82€

1.4 Zjarrfikësit, kodi i programit, nënprogramit 18428, shuma e mjeteve 773.88€

1.5 Zyra për Komunitete dhe Kthim, kodi i programit, nënprogramit 19620, shuma e mjeteve 128.40€

1.6 Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbrojtja civile, emergjenca, kodi i programit, nënprogramit 18184, shuma e mjeteve 5,091.99€

1.7 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, kodi i programit, nënprogramit 85024, shuma e mjeteve 2,038.17€

1.8 Drejtoria e Inspektiveve, kodi i programit nënprogramit 166, shuma e mjeteve 3,080.05€

Totali i mjeteve19,575.16€

4. Shqyrtim i Propozim-Vendimit për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – propozoi për mirënjohje Mensur Kasumin i cili ka qenë zëvendëskomandant në ZO- të Shalës për merita në luftë, si dhe Bekim Krasniqin gjithashtu pjesëtar i UÇK-së për kontributin e tij si ushtar i dalluar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi Xhafer Istrefin (post mortum), që t’i ndahet çmimi “Nderi i qytetit”. Ai në vazhdim paraqiti një arsyetim të propozimit të tij duke shtuar se, Xhafer Istrefi ka qenë veprimtar i devotshëm i çështjes kombëtare, dhe njëherit edhe themelues dhe kryetar i SHFD-së dega në Vushtrri, si dhe është baba i dëshmorit Shemsi Istrefi.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – propozoi për mirënjohje (post mortum) Sadri Maksutin dhe Sadik Malen, të vrarë në janar të vitit 1990.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - lidhur me propozimin për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, ceku se përshkrimet që janë dhënë si arsye nuk janë të mjaftueshme për disa persona. Pastaj theksoi se mendon se edhe “Mirënjohjet” janë dhënë dhe po vazhdojnë të jepen në mënyrë “klienteliste”. Prandaj, ne kërkojmë që nga viti i ardhshëm propozimet të vijnë edhe nga tubimet publike me qytetarë dhe të formohet një komision i ri në përbërje më të gjerë, në të cilin do të përfaqësoheshin të gjitha subjektet politike që janë aktualisht të përfaqësuara në kuvend, dhe po ashtu të jenë të përfaqësuar anëtarët e shoqërisë civile dhe anëtarët e organizatave të ndryshme që operojnë në Vushtrri.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se e mbështet propozimin për mirënjohje të bërë nga anëtar i kuvendit Isa Hajrizi. Pastaj propozoi për ngjarjet e vitit 1981 të bëhet një akademi përkujtimore dhe të nderohen katër të rënë në demonstratat nga komuna jonë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – kërkoj sqarim për faktin se në bazë të rregullores duhet të bëhen vetëm dhjetë propozime dhe atë 7 nga ekzekutivi dhe 3 nga ana e kuvendit andaj tani po kemi shumë zvarritje dhe kuvendi po del në një pozicion jo të mirë para qytetarëve.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - paraqiti sqarime të nevojshme konform Rregullores për dekoratat për mënyrën e paraqitjes së propozimeve dhe mënyrën e votimit.

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit – propozoi Fatime Hazirin për mirënjohje.

Sabri Ferati, anëtar i kuvendit - propozoi Xhemajl Mulakun për mirënjohje për kontributin e tij për ofrimin e ndihmës për UÇK-në, si dhe Rifat Dërgutin zejtari i vjetër vushtrrias.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - propozoi që organizatës “TIKA” që t’i ndahet një mirënjohje për shkak të kontributit që ka dhënë në shumë sfera në Komunën e Vushtrrisë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se shumë nga propozimet e bëra mund të ekzistojnë në listën e mirënjohjeve, të cilët kanë marrë mirënjohje më herët, andaj një listë të tillë e posedon Sekretaria e Kuvendit dhe kërkoj që këta emra të propozuar të verifikohen nëse ekzistojnë në këtë listë.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - propozoi Hysni Gërgurin për mirënjohje për kontributin e tij në lëmin e shëndetësisë.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – propozoi Remzije Zekollin për mirënjohje si punëtore e dalluar në Administratën komunale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – propozoi që Bedri Tahirit që t’i ndahet çmimi “Pena e artë”.

Mehemet Selaci, anëtar i kuvendit - njoftoi se LVV-ja nuk do jetë pjesë e Komisionit për numërim dhe nuk do të marrin pjesë në votim për faktin se kjo çështje tashmë e ka humbur seriozitetin.

Në vazhdim kuvendi me 20 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Formohet Komisioni për mbarëvajtjen dhe numërimin e votimit të fshehtë lidhur me Propozim-Vendimin për ndarjen e mirënjohjeve në këtë përbërje:

**Xhevahire Asllani,
Agim Bregaj dhe
Bahrije Pllana.**

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - pas përfundimit të votimit të fshehtë i lexoi emrat e 10 propozimeve më të votuara.

Pas përfundimit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të fshehta, në lidhje me Propozim-Vendimin për ndarjen e mirënjohjeve për nder të 17 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, Kuvendi vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim, për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 Qershor 2015 nderohen me mirënjohje:

1.1 Nazif Shala (post mortum) i ndjekur politik, iniciator për formimin e Këshillit për grumbullimin e mjeteve materiale për punëtorët e arsimit në Vushtri.

1.2 Avni Rashica (post mortum) anëtar i Këshillit për grumbullimin e mjeteve materiale për punëtorët e arsimit në Vushtri;

1.3 Mensur Kasumi, për kontribut të çmuar në luftën e fundit për çlirim në Zonën Operative të Shalës.

1.4 Rifat Dërguti, zejtari i vjetër vushtrrias.

1.5 Fatime Haziri, për kontributin e çmuar për familjet me gjendje të rëndë sociale.

1.6 Organizata "Tika", për kontributin e dhënë në mënyrë të vazhdueshme që nga paslufta në Sektorin e shëndetësisë, bujqësisë dhe arsimit.

1.7 Bekim Krasniqi, për kontributin e tij si ushtar i dalluar i UÇK-së në Zonën Operative të Shalës.

1.8 Arber Igrishta, nxënës i dalluar, përfaqësues i Kosovës në garat e matematikës.

1.9 Bedri Xhema, për kontributin e tij të dalluar në Lëmin e trashëgimisë kulturore.

1.10 Remzije Zekolli, punëtore e dalluar në Administratën komunale të Vushtrrisë.

Lidhur me propozimet për ndarjen e çmimeve "Qytetar nderi", "Nderi i qytetit", dhe çmimin "Pena e artë" Kuvendi konform Rregullores për Ndarjen e Dekoratave, pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim Selatin Novosella nga Komuna e Prishtinës shpallet "Qytetar nderi i Komunës së Vushtrrisë", për kontributin e tij për çështjen kombëtare.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 Qershor - Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.

1. Me këtë Vendim Xhafer Istrefit (post mortum) nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Nderi i qytetit", për kontributin dhe sakrificën e dhënë për çështjen kombëtare.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 Qershor -Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.

1. Me këtë Vendim Bedri Tahirit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Pena e artë", për merita të veçanta në fushën e krijimtarisë letrare.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 Qershor - Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 18:15.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit